

MASAT PARAMBROJTËSE:

• Mbajeni në vende të sigurta dhe të paarrtëshme nga fëmijët. • Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë. • Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze. • Evitoni kontaktet e syve dhe të lëkures me preparatin. • Evitoni thithjen e avujve të preparatit me organet e frymemarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkatës dhe gjatë spërkatjes. • Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pijë ujë dhe duhan. • Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse, duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit. • Bëni shkatërrimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

• Në rast gëlltije, marrje me organet e frymëmarrjes dhe me lekurën, shkakton këto shenja helmimi: dermatit, konjuktivit, vjellje, diare, apati. • Në rast dmtimi, kërkoni ndihmë mjekësore në qendrën spitalore më të afert dhe tregojini mjekut etiketën. • Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi simptomatik.



Dt. Prod.: printuar në ambalazh
Periudha e ruajtjes: 3 vjet

1 Litër

TAIFUN ADAMA



“Produkt për mbrojtjen e bimëve”

Lënda vepruese: 36 % Glyphosate (48,6% Kripe IPA Glyphosate)

Formulimi: Koncentrat i tretshëm në ujë (SL)

Nr. i regjistrimit: 511/1, datë 15.11.2018

HERBICID I PAS MBIRRJES, ME VEPRIM TOTAL, DUKE KONTROLLUAR SI BARËRAT GJETHEGJËRA ASHTU EDHE ATO GJETHENGUSHTA NE PERIUdhËN E Rritjes Aktive

Frazat e rrezikut: H410, H318, EUH401

Frazat parandaluese: P102, P280, P305+P351+P338, P501, SP1



Distributor:
MELDI Sh.p.k.
Tiranë - Shqipëri



Aplikant: **ADAMA Agriculture BV**
Prodhuesi: **ADAMA Agan Ltd, Israel**

PËRDORIMI:

Përdoret për kontrollin e barërave të këqia në agrume, pemë frutore farore e bërthamore, ullinj, vreshta, trëndafilshite, etj. Nuk rekomandohet në pemtoret dhe vreshtat e reja.

Përveç bujqësisë ka gjetur përdorim edhe në kontrollin e barërave në bordura dhe anët e rrugëve, midis shinave hekurudhore dhe mjediseve të tjera, ku prania e barërave është shqetësuese.

Doza e përdorimit: 6-12 lit preparat/ha, duke përdorur 200-500 litra ujë, në vartësi të zhvillimit të barërave të këqia. Kundër barërave të këqia një vjecare gjethengushta dhe gjethegjëra si: *Rumex hyumenosepalus*, *Truska (Cyperus spp)*. *Cirsium arvense*, *Talla (Sorghum halepense)*, me 6 lit preparat/ha. Kundër barërave mesatarisht rezistente si: *Artemisia spp.*, me 8 lit preparat/ha.

Kundër barërave rezistente doza mund të shtohet: për graminoret 10 lit preparat/ha, për *Convolvulus spp.* apo kallamishet (*Phargmites spp.*) 12 lit preparat/ha.

Vërejtje për përdorimin: Shmangni kontaktin e pikave spërkatese me kulturat e tjera bujqësore. Mos spërkadni në ditë me erë.

Mos trajtoni barërat e këqia të cilat vuajnë nga strese të ndryshme si thatësia, të ftohtit etj. Nuk përzihet me produkte të tjera me reaksion alkalin ose acid. Mënjaroni përdorimin në tokat shumë ranore. Përdoret ekskluzivisht në kohën dhe për qëllimet e parashikuara në këtë etiketë. Çdo përdorim tjetër do të ishte me rreziqe.

Fitotoksiciteti: Nuk aplikohet.

Ndikimi në mjedis: Mesatarisht helmues për gjitarët. Mesatarisht helmues për zogjtë. Pak helmues për bletët. Mesatarisht helmues për peshqit dhe për jovertebrorët ujorë. Mos ndotni ujrart dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij.

Karenca: Nuk aplikohet.

Magazininimi: Preparati ruhet në vende të errëta pa diell dhe pa lagështi, në temperaturë -5°C deri në 35°C.